

Numri i lëndës: 2023:103795

Datë: 14.03.2024

Numri i dokumentit: 05455156

CP.nr.147/2023

Gjykata Themelore Gjilan dega e V.së, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, sipas gjyqtarit Raif Fazliu, duke vendosur në çështjen juridike përmbareme të kreditores A.I., nga fshati B., komuna e V.së, të cilën me autorizim e përfaqëson M.A., avokat në V., ndaj debitorit Komuna e V.së, Drejtoria Komunale për Arsim, me bazë juridike kompensimi i shpërblimit jubilar dhe shpenzimeve të ushqimit në shumë prej **1,472.39 euro**, gjykata jashtë seancës gjyqësore më datë 14.03.2023, bie këtë:

A K T V E N D I M

I.Përfundohet, procedura përmbareme e kreditores A.I., nga fshati B., komuna e V.së, të cilën me autorizim e përfaqëson M.A., avokat në V., në këtë çështje juridike përmbareme.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore Gjilan dega e V.së, kishte lejuar propozimin me nr. **CP.nr.147/2023**, të datës 26.07.2023 ndaj kreditores A.I., nga fshati B., komuna e V.së, të cilën me autorizim e përfaqëson M.A., avokat në V. j, kundër debitorit Komuna e V.së, Drejtoria Komunale për Arsim, me bazë juridike kompensimi i shpërblimit jubilar dhe shpenzimeve të ushqimit në shumë prej **1,472.39 euro**, sipas dokumentit përmbareme.

Gjykata më datën 14.03.2024 kishte pranuar parashtresën nga ana e të autorizuarit të kreditores / e cila parashtresë ishte konfirmuar se debitori e ka përmbushur detyrimin në tërsi .

Gjykata pas vlerësimit të parashtresës konstaton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, që të përfundohet procedura përmbareme ndaj debitorit duke u bazuar në parashtresën e paraqitur, pranë kësaj Gjykate .

Pasi që gjykata ka konstatuar se debitori e kishte përmbushur detyrimin ndaj kreditorit, gjykata konform nenin 42 parag.2 dhe 66 parag. 4 të LPP-ës, ka përfunduar procedurën duke vendosur si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gj y q t a r i
Raif Fazliu

Udhëzimi mbi Mjetin Juridik : Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, 7 ditë pas ditës së pranimit të të njejtit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.